



Datë: 01.12.2025

Numër Protokolli: 7847/2025

A.nr.1865/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.840/2023 të datës 27.10.2025, të Gjykatës Themelore të Prishtinës–Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.252/2023, të datës 27.01.2023, të parashtruar nga ankuesi B.K, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve të punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 01.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.252/2023, e datës 27.01.2023, e parashtruar nga ankuesi B.K, në atë mënyrë që **anulohet** Formulari i datës 10.01.2023, lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2022.

II. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit për Armë, Municione dhe Eksplozivë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2022.

III. Obligohen Sekretarja e Përgjithshme dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II dhe III të këtij dispozitivi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, B.K (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 22.08.2013 në pozitën *Zyrtar i lartë për shënjim, gjurmim, deaktivizim dhe shkatërrim*, në Departamentin e Sigurisë Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 27.01.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1022/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 10.01.2023.

Tutje, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), më datë 22.03.2022 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.252/2023, me të cilin vendim e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për vitin 2022 të datës 10.01.2023.

Ndërsa, ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër A.nr.252/2023 të datës 22.03.2022, të Këshillit, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me datë 27.10.2025, ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.840/2023, i pranuar me datë 04.11.2025 dhe protokolluar me numër 7136/2025 në Këshill, përmes të cilit ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit (ankuesit), rrjedhimisht ka anuluar vendimin kontestues, duke kthyer duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje, tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1022/2023 e datës 27.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për 23.07.2022 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 10.01.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.11.2015; Vendim i datës 10.02.2022 me nr.219/2022; Vendim i datës 28.07.2022 me nr.1187; Vendim i datës 27.10.2022 me nr.0721; Vendim i datës 28.11.2022 me nr.1774/2022; Vendim i datës 04.04.2022 me nr.527/2022; E-mail zyrtar i datës 28.11.2022 –Raporti i vlerësimit afatmesëm 2018 -2022 të udhërrëfyesit për AVL; E-mail Zyrtar i datës 05.01.2023-Raporti i dhjetorit 2022 dhe i tërë vitit 2022; E-mail zyrtar i datës 28.1s 0.2022; E-mail zyrtar i datës 24.10.2022; E-mail Zyrtar i datë 20.10.2022; E-mail zyrtar i datës 18.10.2022; E-mail zyrtar i datës 17.10.2022; E-mail zyrtar i datës 17.10.2022; E-mail zyrtar i datës 15.09.2022-kërkesë; E-mail zyrtar i datës 12.09.2022; E-mail zyrtar i datës 23.08.2022; E-mail zyrtar i datës 27.07.2022; E-mail zyrtar i datës 26.07.2022; E-mail zyrtar i datës 20.06.2022; E-mail zyrtar i datës 17.06.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.02.2023 me numër protokoli 1408/2022; Përgjigje në ankesë e datës 07.03.2023 nga organi i punësimit me numër protokoli 2430/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 22.08.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 10.01.2023; Përgjigje e datës 26.02.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 dhe Plani vjetor i Departamentit për Siguri Publike për vitin 2022; Aktgjykimin A.nr.840/2023 të datës 27.10.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, si dhe duke marr parasysh pikëpamjet juridike sipas Aktgjykimit A.nr.840/2023 të datës 27.10.2025, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka gjetur se lënda e ankuesit duhet të kthehet në **ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, konstaton se Udhëheqësi i Divizionit për Armë, Municione dhe Eksplozivë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, Ulët dhe Profesional të datës 10.01.2023, ankuesin për vitin 2022 e ka vlerësuar me notë të përgjithshme 2.87 që nënkupton mirë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2022 të datës 10.01.2023, pretendon se vlerësimi është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe

dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të sipër theksuara të ankuesit, ka analizuar dispozitat ligjore të legjislacionit të aplikueshëm në periudhën e parashtrimit të ankesës së ankuesit në Këshill dhe nxjerrjes së aktit kontestues, përkatësisht:

- Nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njesisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë. 5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit. 10. Nivelet e mundshme të vlerësimit të rezultateve në punë janë: 10.1. shkëlqyeshëm; 10.2. shumë mirë; 10.3. mirë; 10.4. kënaqshëm ose mjaftueshëm; 10.5. jo kënaqshëm ose jo mjaftueshëm.

Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, përkatësisht:

- Nenit, i cili përcakton se: Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret, metodologjinë dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike.

-Nenit 3 paragrafit 1.1 ku përcaktohet se: 1.Termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim: 1.1. Vlerësimi i rezultateve në punë – nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrat Publike si dhe në pajtim me këtë Rregullore.;

-Nenit 4, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të paracaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit – sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësisë në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë.;

-Nenit 5, i cili përcakton se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar).;

-Nenit 6, ku përcaktohet se: 1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuari) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen

e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet. 2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë. 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit.; si dhe,
- Nenit 7 i cili parasheh se: Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme.

Prjedhimisht, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore dhe shkresat e bashkangjitura të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit gjejnë mbështetje ligjore, për arsye se Këshilli me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 06.02.2023, ndër të tjera si dëshmi kishte kërkuar: *Takimin ndërmjet ankuesit dhe udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë lidhur me përmbushjen e objektivave të punës; Dëshmi lidhur me atë se a është zbatuar plani i punës nga ana e ankuesit në lidhje me objektivat e punës dhe sa është realizuar; Ftesën/njoftim nga ana e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit (nëse ka pasur) për arritjen e objektivave në tërësi; ndërsa, organi përkatës i punësimit, me provat e bashkangjitura me rastin e dërgimit të përgjigjes në ankesë të datës 07.03.2025, nuk ka argumentuar se me rastin e vlerësimit të ankuesit janë respektuar rregullat, kriteret, metodologjinë dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë, përkatësisht nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nuk vërehet se ankuesi ka zhvilluar takim me udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë apo se paraprakisht janë përcaktuar objektivat e punës, konstatim ky i vërtetuar nga e-maili i datës 26.02.2023, i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë i ankuesit dërguar zyrtares B. Sh, në të cilin ndër të tjera, i njëjti ka theksuar se vlerësimi i të gjithë zyrtarëve të Divizionit për Armë, Municione dhe Eksplozivë, është bërë kryesisht mbi bazën e përshkrimit të detyrave të punës, i cili bazohet Planin Vjetor të Departamentit për Siguri Publike për vitin 2022, dhe se mbi këtë plan veprojnë për të përmbushur objektivat, ndërsa ka theksuar se për shkak të angazhimeve të tepërta, nuk ka mundur ta takon secilin zyrtarë, por i ka vlerësuar si gjithmonë, pa asnjë tendencë.*

Andaj, bazuar në konstatimin e më sipërm dhe në respektim të rregullave, kriterëve, metodologjisë dhe procedurave për vlerësimin e rezultateve në punë, Kolegji i Këshillit, vendosi të anuloi Formularin e datës 10.01.2023, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022, me obligimin që Udhëheqësi i Divizionit për Armë, Municione dhe Eksplozivë, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, duke vepruar në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, të bëj rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2022.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1865/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.K;
- Gjyqtarës Albana Çeku - Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme (Udhëheqësit të Divizionit për Armë, Municione dhe Eksplozivë, Sekretarës së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore);
- Arkivit të KPMSHCK-së.